KOMUNIKATË PËR MEDIA

Konferencë me Media – Java e VI -të në terren e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

13. maj 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sot u mbajt Konferencë me Media lidhur me ecurinë e punës në terren që nga fillimi i Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024) më 04 prill 2024.

U.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, ka deklaruar se deri më tani janë regjistruar mbi 1 milion e 400 mijë persona.

Është java e fundit e Regjistrimi të Popullsisë dhe nuk kemi sfida profesionale. Stafi në terren është duke funksionuar, si ashtu edhe pajisjet.
Të gjitha komunat janë duke marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë, gjithashtu edhe në Veri, megjithëse ka një hezitim në një pjesë të kësaj popullsie.

Një komunë ka kërkuar shtyrjen e Regjistrimit për ata duke qenë se në fillim kanë pasur vonesë në fillimin e tij.
Regjstrimi i Popullsisë është duke u monitoruar në kohë reale, pra gjatë ditës së njëjtë të grumbullimit të të dhënave, si nga burimet e jashtme dhe aq më shumë nga të dhënat prej Regjistrimit të kaluar të popullsisë.

Ky Regjistrim është dukshëm me kualitet më të lartë të të dhënave, duke marrë parasysh teknologjinë, dhe përgatitjen dhe përvojën e ASK në këtë proces.
Procesi i Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë sipas të gjitha gjasave do të përfundojë sipas planit.